




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT SHKODER



Nr. 263/1 prot.

Shkodër, më 07.04.2026


Lënda: Mbi Vendimin nr. 23, datë 26.03.2026 të Këshillit Bashkiak Vau Dejës

KËSHILLI BASHKIAK VAU DEJËS

Prefekti i Qarkut Shkodër, në zbatim të detyrave të tij funksionale të përcaktuara në ligjin nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, neni 8, shkronja “a”, të Urdhërit të Kryeministrit nr. 21, datë 05.02.2025 “Për detyrat të administratës së Prefektit të Qarkut”, të Urdhërit të MB nr. 39, datë 20.02.2025 “Për miratimin e rregullores së brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut”, si dhe aneksin I, “Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollin nga Prefekti i Qarkut”, të ligjit nr. 139/2015 “Për veteqeverisjen, vendore”, të ndryshuar, neni 29, neni 54, shkronja “dh”, neni 55, pika 3, neni 64, shkronja “c”, të ligjit nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”, neni 30, shkronja “gj”, neni 41, pika 2, të VKM nr. 329, datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës ekonomike shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, Kreu III, shkresës nr.2302 datë 31.03.2026 të Kwshillit të Bashkisë Vau-Dejës shqyrtoi vendimin nr.23 datë 26.03.2026 “Mbi ri-shqyrtimin e Vendimit nr.10 dt.29.01.2026 “Mbi dhënien e ndihmës financiare familjeve që janë dëmtuar nga përmbytjet me datë 26.10.2025 banorëve të bashkisë Vau-Dejës” me vlerë totale të dëmeve ndërtimore në masën 50% e vlerësimit ose 533 890 lekë, sipas shkronjës “ç”, pika 3, Kreu III të VKM 329/2012.

Për sa trajtuar, Prefekti ju autorizon procedimin.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,



PREFEKTI

Holta DUDA

BASHKIA VAU DEJËS
KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr. 23 datë 26.03.2026**“Mbi rishqyrtimin e Vendimit nr.10 dt.29.01.2026 “Mbi dhënien e ndihmës financiare familjeve që janë dëmtuar nga përmytjet me dt.26.10.2025 banorë të Bashkisë Vau Dejës”**

Në mbështetje të ligjit Nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”i ndryshuar,Ligjit Nr.45/2019 “Për mbrojtjen civile”, VKM-së Nr.329 datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”,pika III nenin a,b,c,d,dh ,Udhezimi i përbashkët i Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Financave nr.263 dt.24.05.2013 “për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore, financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore” , në shkresën Nr.373/1 dt.17.05.2016 të Prefekturës së Qarkut Shkodër “Në lidhje me çmimet e mobiljeve, orendive dhe pajisjeve elektroshtëpiake të dërguara nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve” si dhe pas shqyrtimit te projekt vendimit Nr.3 dt.18.03.2026, paraqitur nga Sektori i Emergjencave Civile , ku propozohet rishqyrtimi i Vendimi i Këshillit Bashkiak nr.10 dt.29.01.2026 “Mbi dhënien e ndihmës financiare për 38 (tridhjetë e tete) familjet që janë banorë të Njesisë Administrative Vau Dejës , Bushat dhe Hajmel të Bashkisë Vau Dejës,Këshilli Bashkiak:

V E N D O S I:

- 1.Miratimin e dhënies së kompensimit për familjen e z.**Ernest Ndue Paluku** banues në Qytetin Vau Dejës të cituara në shkresën përcjellëse të Prefekturës së Qarkut Shkodër nr.96/1 dt.13.02.2026 “Mbi vendimin e Keshillit Bashkiak nr.10 dt.29.01.2026 “ pasi grupi i punës pas njohjes me objektin e kërkeses ka bere vlerësimin bazuar në VKM Nr.329/2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore, pika III.
- 2.Të miratojë dhënien e kompensimit për familjen e zj. **Mri Gjokë Leka** banues në Barbullush (Hoten) të cituara në shkresën përcjellëse të Prefekturës së Qarkut Shkodër nr.96/1 dt.13.02.2026 “Mbi Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr.10 dt.29.01.2026” pasi grupi i punës pas njohjes me objektin e kërkesës ka bere vlerësimin bazuar në VKM Nr.329/2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore, pika III.
- 3.**Miratimin** e dokumentacionit tekniko ligjor të hartuar nga Bashkia Vau Dejës , për 2 (dy) familjet sipas listës bashkëngjitur me vlerën totale të dëmit **1.067.780** (dhjetëmilion e gjashtedhjetë e shtatë mijë e shtatëqind e tetëdhjetë) lekë.



4.Miratimin e dhënies së ndihmës financiare sipas proces verbaleve të vlerësimit për 2 (dy) familjet e dëmtuara nga përmbytjet në masën 50% të vlerës totale të dëmit me shumën **533.890** (pesëqind e tridhjetë e tre mijë e teteqind e nëntëdhjetë) banorë të Bashkisë Vau-Dejës.

5.Efektet: Krijon lehtësira për përballimin e situatës emergjente të banoreve të dëmtuar.

6.Burimi i financimit do të jetë fondi i Bashkisë i planifikuar për programin e Mbrojtjes Civile i miratuar në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.74 dt.23.12.2025 "Mbi miratimin e Buxhetit 2026" konfirmuar nga Prefektura Shkoder me shkresën nr.884/1 dt.07.01.2026.

7.Ngarkohen Drejtoria e Ekonomike (Sektori i Buxhetit dhe finances) për zbatimin e këtij vendimi.

8.Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore"i ndryshuar).

SEKRETARI I KESHILLIT
Ardian CELEPIJA

KRYETARI I KESHILLIT
Ervis SHIJAJ



Miratuar me 18vota
Vota pro 18..
Vota kunder
Vota Abstenim
Zbardhur me date 31.03.2026



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJËS
SEKTORI I EMERGJENCAVE CIVILE

PROJEKT VENDIM

Nr.3 datë 18/03/2026

Rishqyrtim Vendimi nr.10 dt 29.01.2026 “Mbi dhënien e ndihmës financiare familjeve që janë dëmtuar nga përmbytjet me dt.26.10.2025 banorë të Bashkisë Vau-Dejës”.

Bazueshmëria ligjore e projekt vendimit të propozuar është:

Ligji Nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligji Nr.45/2019 “Për mbrojtjen civile”, VKM-së nr.329 datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore” pika III, neni a,b,c,d,dh, Udhëzimi i përbashkët i Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Financave, Nr.263, datë 24.05.2013 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore, financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, si dhe në shkresën Nr.373/1 dt.17.05.2016 të Prefekturës së Qarkut Shkodër “Në lidhje me çmimet e mobiljeve, orendive dhe pajisjeve elektroshtëpiake të dërguara nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve,”

V E N D O S I :

1. Të miratojë dhënien e kompensimit për familjen e z.**Ernest Ndue Paluku** banues në qytetin Vau Dejës të cituara në shkresën përcjellëse të Prefekturës së Qarkut Shkodër nr.96/1 dt.13.02.2026 “Mbi vendimin e Këshillit Bashkiak nr.10 dt.29.01.2026 “ pasi grupi i punës pas njohjes me objektin e kërkesës ka bërë vlerësimin bazuar në VKM Nr.329/2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore.
2. Të miratojë dhënien e kompensimit për familjen e zj. **Mri Gjokë Leka**, banues në Barbullush (Hoten) të cituara në shkresën përcjellëse të Prefekturës së Qarkut Shkodër nr.96/1 dt.13.02.2026 “Mbi Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr.10 dt.29.01.2026”, pasi grupi i punës pas shqyrtimit të kërkesës me nr.2747 dt.30.10.2025 bazuar në VKM Nr.329/2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

3. **Të miratojë** dokumentacionin tekniko-ligjor të hartuar nga Bashkia Vau Dejës, për 2 (dy) familjet sipas listës bashkëngjitur në vlerën totale të dëmit **1.067.780** (një milion e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e shtatëqind e tetëdhjetë) lekë.
4. **Të miratojë** dhënien e kompensimit sipas proces verbaleve të vlerësimit për 2 (dy) familjet e dëmtuara të hartuar nga grupi i verifikimit dhe vlerësimit, në masën **50%** të vlerës totale me shumën **533.890** (pesëqind e tridhjetë e tre mijë e tetëqind e nëntëdhjetë) (bashkëngjitur lista e familjeve e detajuar)
5. **Efektet:** Krijon lehtësira për përballimin e situatës emergjente të banorëve të dëmtuar.
6. **Burimi i financimit** do të jetë fondi i Bashkisë i planifikuar për programin e Mbrojtjes Civile i miratuar në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.74 dt.23.12.2025 "Mbi miratimin e buxhetit 2026" konfirmuar nga Prefektura me shkresën nr.884/1 date 07.01.2026.

Konfirmoi bazën ligjore


26

Konfirmoi bazën financiare



Konceptoi

Valjeta NIKAJ



KRYETARI

Kristian SHKRELI

ME VENDIM DELEGIMI

ZV/KRYETARI

Aleksandra GJONI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJËS

Nr. — prot.

Vau Dejës, më 18.03.2026

RELACION

Drejtuar : KËSHILLIT TË BASHKISË VAU DEJËS

Lidhur shkresën tuaj nr.96/1 prot dt.29.01.2026”Mbi Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr.10 dt.29.01.2026” Mbi dhënien e ndihmës financiare familjeve që janë dëmtuar nga përmbytjet me dt.26.10.2025 banorë të Bashkisë Vau Dejës ju sqarojmë si më poshtë:

Familja e z.**Ernest Ndue Paluku** banues në Qytetin Vau Dejës të Bashkisë tonë ka paraqitur kërkesën me nr.praktike 2663 dt.27.10.2025 me objekt”.” Vleresim dëmsh në biznes qe përdorej si objekt banimi” komisioni i ngritur me urdherin e Kryetarit të Bashkisë Nr.714 dt.27.10.2025 ka berë vlerësimin vetëm per pjesën e objektit që ka shërbyer si banese (vlerësim për mobiljet,orendite, e pajisjet elektroshtepiake të dëmtuara) bazuar në VKM Nr.329/2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njërëzore, pika III ”Procedura në rastet kur nuk shpallet gjendja e emergjencës civile”, pika a, b,c,d dhe dh. si dhe në shkresën Nr.373/1 dt.17.05.2016 të Prefekturës së Qarkut Shkodër “Në lidhje me çmimet e mobiljeve, orendive dhe pajisjeve elektroshtepiake të dërguara nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve,”

Për pjesën e dëmeve në biznes grupi i punes nuk ka bërë asnjë vlerësim bazuar ne VKM 329/2012 III” Procedurat në rastet kur nuk është shpalle gjendja e emergjencave civile” Rrjedhimisht nuk ka mospërputhje kontradiktore përsa i përket dokumentave të hartuara nga ana e komisionit të ngritur sipas urdhrin të kryetarit të Bashkisë (bashkëngjitur proces verbali i Konstatimit dhe Vleresimit për shtetasin e mësipërm.).

Familja e zj.**Mri Gjokë Leka** banues në fshati Barbullush (Hoten) të Njesisë Administrative Bushat të Bashkisë tonë ka paraqitur kërkesën me nr.praktike me nr.2747 dt.30.10.2025 me objekt”.” Vleresim dëmsh në stallën e blegtorisë dhe bazës ushqimore “ komisioni i ngritur me urdherin e Kryetarit të Bashkisë Nr.714 dt.27.10.2025 ka berë vlerësimin e objektit të banimit (vlerësim për mobiljet,orendite, e pajisjet elektroshtepiake të dëmtuara) bazuar në VKM Nr.329/2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njërëzore, pika III ”Procedura në rastet kur nuk shpallet gjendja e emergjencës civile”, pika a, b,c,d dhe dh. si dhe në shkresën Nr.373/1 dt.17.05.2016 të Prefekturës së Qarkut

REK. VALLINA L. VHO


civile”, pika a, b,c,d dhe dh. si dhe në shkresën Nr.373/1 dt.17.05.2016 të Prefekturës së Qarkut Shkodër “Në lidhje me çmimet e mobiljeve, orendive dhe pajisjeve elektroshtëpiake të dërguara nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.”

Për pjesën e stallës, bazës ushqimore etj, grupi i punës nuk ka bërë asnjë vlerësim bazuar në VETP/329/2012 III “Procedurat në rastet kur nuk është shpallë gjendja e emergjencave civile”.

Rrjedhimisht nuk ka mospërputhje kontradiktore përsa i përket dokumentave të hartuara nga ana e komisionit të ngritur sipas urdhrit të kryetarit të Bashkisë (bashkëngjitur Proces verbali i Konstatimit dhe Vlerësimit për shtetasen e mësipërme.)

Pas këtyre relacioneve në lidhje me punën e bërë nga grupi i punës për shqyrtimin e dy kërkesave të banorëve të mësipërm, nuk ka mospërputhje kontradiktore në lidhje me akordimin e ndihmës financiare në masën 50% të vlerës së dëmit për 2 (dy) familjet e mësipërme.

Konceptoi
Valjeta Nikaj



ME VENDIM DELEGIMI
ZV/KRYETARI
Aleksandra GJONI



KRYETARI I BASHKISË
Kristian SHKRELI

VAU DEJES



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

I BASHKIA VAU DEJËS

Vau-Dejes, me dt 16.01.2026

LISTA E FAMILJEVE TË DËMTUARA NGA RESHIET E DT.26.10.2025 NË BASHKINË VAU-DEJËS

Nr rend	Nr. Prakt	Emri	Atesia	Mbiemri	Adresa N.J.A.	Adresa sipas qytet/fshat	Kërkl/ banor data	Nr frymeve	Vlera Demit	50% e vleres per trajtim
1	2631	Angjeline	Kel	Suka	Bushat	Bushat	27.10.2025	5	348,820	174,410
2	2639	Anton	Gjon	Pylla	Vau Dejes	Lagja Deje	27.10.2025	1	235,420	117,710
3	2816	Dode	Gjon	Bregu	Bushat	Plezhe	03.11.2025	5	293,120	146,560
4	2623	Ornan	Ndoc	Shita	Vau Dejes	Vau Dejes	27.10.2025	5	264,500	132,250
5	2680	Edmir	Tefë	Gjergj	Hajmel	Pristull	28.10.2025	2	300,400	150,200
6	2657	Erion		Makaj	Bushat	Rranza	27.10.2025	10	357,660	178,830
7	2663	Ernest	Ndue	Paluku	Vau Dejes	Vau Dejes	27.10.2025	4	754,360	377,180
8	2624	Florian	Kol	Gjoni	Bushat	Rranza	27.10.2024	5	465,340	232,670
9	2802	Françesk	Zef	Bajraktari	Vau Dejes	Vau Dejes	03.11.2025	2	111,300	55,650
10	2618	Gezim	Rustem	Guri	Vau Dejes	Vau Dejes	27.10.2025	4	279,260	139,630
11	2782	Gjon	Preke	Marku	Vau Dejes	Vau Dejes	31.10.2025	6	119,260	59,630
12	2683	Haxhi	Murat	Dajta	Vau Dejes	Vau Dejes	28.10.2025	2	142,200	71,100
13	2722	Jorgo	Zef	Vata	Vau Dejes	Vau Dejes	29.10.2025	2	120,000	60,000
14	2757	Kolë	Prekë	Hila	Bushat	Ashte	30.10.2025	2	161,720	80,860
15	2715	Lazer	Pjeter	Vatmisaj	Bushat	Stajke	29.10.2025	2	369,100	184,550
16	2778	Lindita	Prend	Vizhna	Vau Dejes	Lagjia Deje	31.10.2025	3	153,240	76,620
17	2742	Lindita	Preng	Thepi	Vau Dejes	Vau Dejes	29.10.2025	7	150,660	75,330
18	2697	Liza	Luigj	Krepi	Vau Dejes	Vau Dejes	28.10.2025	2	114,520	57,260
19	2767	Lizë	Shajfen	Dodaj	Bushat	Bushat	30.10.2025	1	407,800	203,900
20	2643	Enk	Gjon	Lala	Vau Dejes	Vau Dejes	27.10.2025	2	313,420	156,710
21	2612	Marki	Pjeter	Bushi	Vau Dejes	Vau Dejes	27.10.2025	8	163,240	81,620
22	2779	Marj		Gjinaj	Vau Dejes	Rranza	31.10.2025	6	331,340	165,670
23	2747	Mri	Gjokë	Leka	Bushat	Fshati I Ri	30.10.2025	5	313,420	156,710
24	2804	Ndrec	Preng	Tanushi	Vau Dejes	Vau Dejes	03.11.2025	3	76,800	38,400
25	2755	Nikolin	Mirash	Guri	Bushat	Ashte	30.10.2025	6	357,400	178,700

VAU DEJES

27	2711	Nusha	Ndrec	Bacaj	Vau Dejes	Vau Dejes	29.10.2025	1	162,020	81,010
27	2710	Pashke	Bardhok	Bacaj	Vau Dejes	Vau Dejes	29.10.2025	2	337,660	168,830
28	2737	Paulin	Mark	Pylla	Vau Dejes	Lagjia Deje	29.10.2025	8	186,720	93,360
29	2644	Petrii	Muhamet	Behari	Vau Dejes	Lagjia Deje	27.10.2025	5	110,900	55,450
30	2736	Pjeter	Gjini	Mbrozi	Vau Dejes	Vau Dejes	29.10.2025	3	325,680	162,840
31	2720	Preke		Lacinej	Bushat	Melgushe	29.10.2025	4	189,060	94,530
32	2633	Prende	Ndue	Gjini	Vau Dejes	Vau Dejes	27.10.2025	3	388,000	194,000
33	2786	Rregjine	Ndue	Brunga	Vau Dejes	Vau Dejes	31.10.2025	1	264,800	132,400
34	2727	Sokol		Ishmakaj	Bushat	Melgushe	29.10.2025	4	380,200	190,100
35	2638	Teofik	Nuh	Mucejani	Bushat	Bushat	27.10.2025	2	240,480	120,240
36	2718	Tone	Jak	Mazi	Bushat	Barbullush	29.10.2025	4	383,860	191,930
37	2709	Vitor	Gjergj	Shpendi	Vau Dejes	Lagjia Deje	29.10.2025	2	324,420	162,210
38	2682	Vitore	Pieter	Marku	Vau Dejes	Vau Dejes	28.10.2025	1	282,420	141,210
Totali 38 familje me shumen									10,280,520	5,140,260

KOMISIONI

Valjeta Nikaj

Ing Indrit Kurtbegu

Ing Greta Matija

Ardian Firza

Ing Gzim Likaj

**MIRATOHET
KRYETARI I BASHKISE
Kristian SHKRELI**

**ME VENDIM DELEGJIM
ZV/KRYETARI
Aleksandra GJONI**

